

REHABILITIM I RRJETIT HIDRIK TË TIRANËS

Ka nisur puna për rehabilitimin e rrjetit hidrik të Tiranës, një investim 10.5 milionë euro i financuar nga Qeveria Italiane. Projekti parashikon ndërtimin e linjës së transmetimit, në standardin e vendeve të BE, dhe do të përmirësojë furnizimin me ujë për qytetin e Tiranës dhe zonat përreth, do të shmangë abuzimet dhe do të eliminojë humbjet në rrjet.

MARRËVESHJE ME SHELL PËR BLOKUN 2 & 3

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe kompania SHELL kanë nënshkruar mes tyre marrëveshjen për "Amendimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes hidrokarbure për bllokun 2 dhe 3". Marrëveshja është një arritje e rëndësishme në drejtim të rritjes dhe modernizimit të sektorit të hidrokarbureve në vend dhe siguron që Qeveria Shqiptare të marrë një pjesë të fitimit që në prodhimin e fuçisë së parë të naftës.

KUKËS- MORINË, GATI PËR SEZONIN TURISTIK

Punimet në aksin Kukës-Morinë do të përfundojnë në fund të muajit qershor për të qenë gati për të përballuar fluksin e qarkullimit përgjatë sezonit veror. Përtej vështirësive teknike, të shfaqura gjatë zbatimit të projektit, punimet pritet të përfundojnë në afatin e parashikuar. Puna po vijon për dublimin e urave, rehabilitimin e rrugës dhe me marrjen e masave për rritjen e sigurisë.

VIZITË NË QARKUN KUKËS

Në kuadër të vizitës në qarkun e Kukësit, ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku inspektoi disa institucione që ofrojnë shërbime për qytetarët si Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, pikën Kufitare të Morinës dhe Spitalin Rajonal, ku po kryhet një investim shumë i rëndësishëm. Gjatë vizitës Balluku u ndal edhe në një biznes fason në të cilin, me ndërmjetësimin edhe të Zyrës së Punës, janë punësuar 105 punonëtorë.

OSHEE, MASA PËR SEZONIN TURISTIK

Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Shkodër, ka nisur me marrjen e masave paraprake për garantimin e një sezoni turistik me furnizim të qëndrueshëm me energji. Në zonën e Shirokës në Shkodër, u bë i mundur sistemimi i rrjetit të tensionit të ulët me kablo ABC. Në ditët në vijim puna shtrihet edhe në linjat e tjera.

OST, LINJË 1.5 KM NË SEGMENTIN FIER-BALLSH

Brigada e linjave të Njesisë Operative Fier, në bashkëpunim me grupet e Njesisë së Mirëmbajtjes së Transmetimit, kryen një ndërhyrje në segmentin e linjës 110-10/1 Fier-Ballsh. 1.5 km linjë u zëvendësua së bashku me përcjellësit dhe me aksesoret e tjerë si izolatorë dhe morseteri. Kjo ndërhyrje përmirëson ndjeshëm sigurinë e furnizimit me energji të Rajonit Jugor.